



Prishtinë, 24.06.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1535_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2285_03_22** i dt.**01.03.2022**;
- Ankesat e konsumatorit: **datë 05.05.2022**

në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit F.B nga komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. **ZRRE/DMK_V_2285_03_22** i dt.**01.03.2022**.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 01.03.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2285_03_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit F.B nga komuna e Prishtinës, kundër vendimit të KESCO-s mbi kontestimin e korigjimeve plotësuese nr. 85164DPR-90066738 dhe nr. 85165DPR-90066738 datë 15.04.2016 për shkak të dyshimit në matjen jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 93350723.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.B brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Vërtetimit të gabuar, të zbehtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi është i mangët dhe i pa bazuar, Bordi thekson se, nuk qëndron një pretendim i tillë, për faktin se, me kujdes dhe ndërgjegje është analizuar çdo provë veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, si në vijim: Ankesat e konsumatorit e datës 13.03.2017;



05.05.2022; Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_2285_03_22 i dt.01.03.2022; Rrjedhën e energjisë elektrike, Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0611738 datë 20.11.2015, Procesverbalin e kontrollimit detal te njehsorit elektrik Nr.Org.02.NR.12851 datë 04.12.2015 si dhe korrigjimet plotësuese nr. 85164DPR-90066738 dhe nr. 85165DPR-90066738 datë 15.04.2016, ka gjetur se ankesa e konsumatorit F.B është e pabazuar.

Duke vështuar nga fillimet e rastit, Bordi gjen se, me datë 20.11.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 93350723 me gjendje TL=016434 kWh dhe TU=025739 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri nr. 64680537 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000kWh. Me datë 04.12.2015 Punëtorët e autorizuar te qendrës se kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 93350723 me gjendje të shpenzimeve TL = 016434 kWh dhe TU = 025739 kWh ku kanë konstatuar se : *“Njehsori elektrik pllombat i ka në rregull, njehsorit elektrik nga ana e jashtme nuk i vërehen dëmtime, kurse në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se: Sistemi i fazës R dhe T janë të djegura dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për 66.66 % me pak”*. Ndërsa sa i përket pretendimeve të konsumatorit se konstatimi i mesiperm është jo i saktë, jo bindës dhe jo argumentues, Bordi konstaton se procesverbali është kryer nga personat e autorizuar dhe është vlerësuar nga komisioni përgjegjës nga qendra e kalibrimit dhe duke qenë se çdo procesverbal është i dokumentuar dhe faktik, deklaratat e konsumatorit lidhur me pasaktësinë nuk qëndrojnë.

Më tutje në shqyrtimin e provave dhe fakteve, Bordi gjen se, me datë 08.12.2015 Departamenti i faturimit ne KEDS e ka ngarkuar konsumatorin me faturën e e rikthimit te humbjeve DPR15HP17728 në vlerë financiare **1,925.39€** te cilën me datë 15.04.2016 e ka anuluar kurse përmes korrigjimeve plotësuese nr. 85164DPR-90066738 dhe nr. 85165DPR-90066738 e ka ngarkuar konsumatorin në vlerë **1,393.74€**, duke u bazuar në procesverbalin mbi kontrollin detal të njehsorit elektrik nr. 93350723, Nr.Org.02.NR.12851 datë 04.12.2015. I pa kënaqur me borxhin e ngarkuar nga KEDS-i me datë 03.02.2016 konsumatori parashtron ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimet shtesë të datës 15.04.2016 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr.93350723. Me datë 10.02.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e tij bazuar në procesverbalin e kontrollit detal të njehsorit elektrik, Nr.Org.02.NR.12851 date 04.12.2015, korrigjim matje jo e saktë faturat 11/2014 deri 10/2015 pasi qe sistemi i fazës R dhe T janë djegur dhe si pasojë njehsori ka regjistruar 66.66% energji elektrike më pak. Bordi konstaton se ka shqyrtuar korrigjimet plotësuese nr. 85164DPR-90066738 dhe nr. 85165DPR-90066738 datë 15.04.2016 në vlerë **1,393.74€**, per faturat e periudhës 11/2014 deri ne periudhën 10/2015 bërë bazuar në procesverbalin mbi kontrollin detal të njehsorit elektrik nr. 93350723, Nr.Org.02.NR.12851 datë 04.12.2015 dhe konstaton se Departamenti i faturimit në KESCO ka vepruar bazuar ne procedurat dhe kodet ne fuqi sipas se cilave ne rastet kur konstatohet se ka defekt ne sistemin matës atëherë duhet te bëhen te gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që per konsumatorët komercial përfshin periudhën 12 mujore.

I pakënaqur edhe me pergjigjen e KESCO-s, konsumatori me datë 13.03.2017 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kundërshtuar korrigjimet shtesë të datës 15.04.2016, për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 93350723. Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të paraqitura e refuzon ankesën e konsumatorit dhe duke analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit, konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime te rregullta mujore dhe se ne disa raste ka evidentuar qe nuk ka qasje ne leximin e njehsorit elektrik si dhe ka sugjeruar qe te behet zhvendosja e njehsorit elektrik. Bordi ka krahasuar shpenzimin e



konsumatori për periudhën kontestuese me njehsorin elektrik nr. 93350723 si dhe shpenzimet për periudhat e më vonshme me njehsorin e ri nr. 64680537 per periudha te njëjta kohore dhe konstaton se konsumatori ka rritje te shpenzimit. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike per periudhën 11/2014 deri ne periudhën 10/2015 me njehsorin elektrik nr. 93350723 mesatarja mujore e shpenzimit është **512.5 kËh/muaj** kurse me njehsorin e ri nr. 64680537 per periudhën 11/2016 deri ne periudhën 10/2017 është **1,570.83 kËh/muaj**, per periudhën 11/2017 deri ne periudhën 10/2018 është **1,637.41 kËh/muaj**, per periudhën 11/2018 deri ne periudhën 10/2019 është **1,789.50 kËh/muaj**, per periudhën 11/2019 deri ne periudhën 10/2020 është **1,550.5 kËh/muaj** si dhe per periudhën 11/2020 deri ne periudhën 10/2021 është **328.83 kËh/muaj**. Pas edhe shqyrtimit të provave tjera dhe korigjimeve shtese, ka konstatuar se vendimi i marrë nga KESCO, është vendim i bazuar në ligj dhe në kodet në fuqi, andaj si i tillë është i vlefshëm.

Bordi i ZrRE me datë 05.05.2022 ka pranuar ankesën e konsumatorit me të cilën e konteston Vendimin e DMK-së : ZRRE/DMK_V_2285_03_22 i dt.01.03.2022 për shkak të vërtetimit të gabuar, të zbehtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar te së drejtës materiale. Pala në ankesën e tij i kundërshton të thënat e nxjerrura nga përsoneat e autorizuar të qëndrës së kalibrimit, përkatësisht procesverbalin e datës 03.12.2015, duke e quajtur “jo të saktë, jo bindës dhe jo argumentues” dhe kërkon nga Bordi që të shqyrtohet ankesa e tij dhe të lirohet nga borxhi i ngarkuar. Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe dokumenteve të tjera, konstaton se:

Duke analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit Bordi konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se në disa raste ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik si dhe ka sugjeruar që të bëhet zhvendosja e njehsorit elektrik. Bordi ka krahasuar shpenzimin e konsumatori për periudhën kontestuese me njehsorin elektrik nr. 93350723 si dhe shpenzimet për periudhat e më vonshme me njehsorin e ri nr. 64680537 për periudha të njëjta kohore dhe konstaton se konsumatori ka rritje të shpenzimit. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën 11/2014 deri në periudhën 10/2015 me njehsorin elektrik nr. 93350723 mesatarja mujore e shpenzimit është **512.5 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri nr. 64680537 për periudhën 11/2016 deri në periudhën 10/2017 është **1,570.83 kWh/muaj**, për periudhën 11/2017 deri në periudhën 10/2018 është **1,637.41 kWh/muaj**, për periudhën 11/2018 deri në periudhën 10/2019 është **1,789.50 kWh/muaj**, për periudhën 11/2019 deri në periudhën 10/2020 është **1,550.5 kWh/muaj** si dhe për periudhën 11/2020 deri në periudhën 10/2021 është **328.83 kWh/muaj**.

Ndërsa sa i përket korigjimeve plotësuese nr. 85164DPR-90066738 dhe nr. 85165DPR-90066738 datë 15.04.2016 në vlerë **1,393.74€**, për faturat e periudhës 11/2014 deri në periudhën 10/2015 bërë bazuar në procesverbalin mbi kontrollin detal të njehsorit elektrik nr. 93350723, Nr.Org.02.NR.12851 datë 04.12.2015, Bordi konstaton se Departamenti i faturimit në KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën 12 mujore.

Bordi i ZrRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit F.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.